

VENDIM
Nr. 41, datë 6.3.2017

**PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “CGC”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR
(SHITJE ME SHUMICË)**

Në mbështetje të nenit 4, pikat 50, 105, 107; nenit 22, pika 2, germa “ç”; nenit 83, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; neneve 4, pika 1, germa “ç”; 8, 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e” dhe nenin 10, pika 1 të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesëshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 11.2.2011; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.3.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “CGC” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të shoqërisë “CGC” sh.p.k.,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “CGC” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1, germa d/i, d/ii) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale (neni 9, pika 1, germa e/i, e/ii, e/v, e/vi) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Rezulton dokumentacion i munguar që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 1, germa d/V, d/VI, doku-mentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor;

- nenin 9, pika 1, germa e/iii, dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale;

- nenin 9, pika 2, germa e/i, e/ii, e/iii, doku-mentacioni specifik për llojin e licencës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “CGC” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

